**UNIVERSITETI I PRISHTINES**
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies në STEM

Me datë 28.04`.2026

| # | Kandidati | Specializimi | Tema e punimit | Komisioni | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Arbitë Thaçi Neziri | Master i Mësimdhënies lëndore/ Mësimdhënie në Teknologji me TIK | Ndikimi i platformës Scratch në zhvillimin e aftësive kreative dhe analitike të nxënësve | kryetar/e | Prof. Asoc. Kyvete Shatri |
| | | | | mentor/e | Prof. Ass. Dr. Sylejman Berisha |
| | | | | anetar/e | Prof. Asst. Edona Berisha - Kida |

UNIVERSITETI I PRISHTINES
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

**Tema** : Ndikimi i platformës Scratch në zhvillimin e aftësive kreative dhe analitike të nxënësve

**Kandidati**: Arbitë Thaçi Neziri

**Komisioni:**

Prof. Ass. Dr. Sylejman Berisha - Mentor

Prof. Asoc. Kyvete Shatri - Kryetar

Prof. Asst. Edona Berisha - Kida - Anëtare

ABSTRAKTI

Ky punim shtjellon ndikimin e këshillimit të hershëm të nxënësve rreth karrierës në orientimin e qëndrueshëm të tyre në arsimin e mëtejshëm. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është identifikimi i ndikimit të orientimit të hershëm në karrierë në formësimin e vendimeve të nxënësve për të ardhmen e tyre profesionale dhe atë akademike. Qëllim tjetër është analizimi planeve të orientimit në karrierë dhe këshillimit të hershëm që ndihmon shumë nxënësit në zhvillimin e një plani të qëndrueshëm për karrierën duke reduktuar kështu pasiguritë në zgjedhjet e tyre.

Pyetjet hulumtuese janë:

*1. A ndikon këshillimi i hershëm në karrierë i nxënësve në zgjedhjet e qëndrueshme të karrierës së tyre?*

*2. Sa ndihen nxënësit të sigurt në zgjedhjet e tyre të karrierës pas orientimit të hershëm?*

Për këtë hulumtim, si hipotezë kemi zgjedhur:

*Këshillimi i hershëm në karrierë ndikon pozitivisht në orientim të qëndrueshëm të nxënësve.*

Metoda e përdorur në hulumtim është sasiore dhe cilësore dhe është realizuar me 60 nxënës në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Faik Konica" në Prishtinë (mostra të qëllimshme) duke përdorur instrumentet: pyetësor me nxënës dhe intervistë me 6 mësimdhënës nga shkencat e natyrës duke marrë qëndrimet e tyre mbi rëndësinë e orientimit të hershëm të nxënësve në karrierë. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë ndikimin e orientimit të hershëm në karrierë tek nxënësit dhe do të reflektojnë përparësitë e informimit mbi orientimin e qëndrueshëm të tyre në karrierë

**Fjalët kyçe:** *arsim, karrierë, nxënës, orientim.*